



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr. 45

Prishtinë, më 17 dhjetor 2018, në orën:13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Shqipe Pantina, Valon Ramadani, Adem Mikullovc, Arban Abrashi, Xhevahire Izmaçu, Rasim Selmanaj, Milaim Zeka dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje munguan: Imet Rrahmani dhe Jasmina Zhivkoviç.

Po ashtu, në mbledhje morën pjesë: kryetarja e Bordit të RTK-së dhe dy anëtarë të Bordit, OSBE, KDI, KTV, Kallxo.com dhe Ekonomia online.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Nait Hasani, kryetar i komisionit.

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Takimi i Komisionit me Bordin e RTK-së;**
- 3. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Takimi i Komisionit me Bordin e RTK-së

Nait Hasani, i njoftoi anëtarët e Bordit se arsyeja e ftesës ka qenë kërkesa e anëtarëve të komisionit nga radhët e LVV dhe komisioni ka miratuar kërkesën e tyre për takimin, lidhur me anulimin e konkursit për zgjedhjen e drejtorit të përgjithshëm të RTK-së. Ai pyeti kryetaren për arsyet e anulimit të konkursit.

Afërdita Maliqi, kryetare e bordit, u përgjigj se arsyeja e anulimit të konkursit ka qenë se nga pesë kandidatët, të cilët kishin aplikuar, vetëm 2 kandidatë i kanë përmbushur kushtet e konkursit dhe pas shqyrtimit të ankesave të kandidatëve të pakënaqur, Bordi i RTK-së, do të shpallë konkursin tjetër.

Valon Ramadani, pyeti: Mbi çfarë baze juridike keni inkorporuar, si kriter të konkursit, 7 vite përvojë menaxheriale në fushën e mediave? A janë kushtet e konkursit të njëjta me konkursin e vitit 2015, nga është marrë kriteri, pasi që ligji në fuqi për RTK-në nuk përcakton vitet si kriter?

Shqipe Pantina, pyeti: Cilat nga kushtet e parapara me konkurs nuk i kanë plotësuar kandidatët, të cilët kanë aplikuar, a duhet patjetër që kandidati për drejtor të RTK-së të ketë 7 vite përvojë menaxheriale në transmetues? Cila është qasja dhe strategjia e ardhshme e bordit për çështjen në fjalë, a do t'i ndryshoni kriteret po që se nuk ka kandidatë që i plotësojnë kushtet e përcaktuara me konkurs?

Ajo, gjithashtu, kërkoi që në procesin e përzgjedhjes të ftohen përfaqësuesit e Ambasadës së Britanisë së Madhe, me qëllim të transparencës, në bazë të marrëveshjes që ata kanë nënshkruar me Kuvendin e Kosovës, për vëzhgim dhe monitorim të përzgjedhjes së kandidatëve në pozita të larta.

Rasim Selmanaj, tha se krejt ajo çka po kërkohet nga Bordi i RTK-së, është të respektohet ligji, dhe konform ligjit, të krijohet mundësia të përzgjidhen kandidatët mbi bazën e transparencës.

Ai, duke cekur dispozitat e ligjit se për drejtor, kandidati duhet të ketë përvojë në fushën e mediave dhe në fushat relevante, ndërsa që inkorporimi i kriterit në konkurs, 7 vite përvojë në fushën menaxheriale në mediat transmetuese është jashtëligjore dhe që është inkorporuar nga ana e bordit, me qëllim të eliminimit të personave që kanë përvojë menaxheriale në fushat relevante.

Milaim Zeka, pyeti: A ka të drejtë drejtori të cilit po i skadon mandati të konkurrojë përsëri?

Afërdita Maliqi, u përgjigj për kriterin 7 vite përvojë, e cila theksoi se bordi ka vendosur unanimisht, ndërsa ka pasur propozime për 5, 7 dhe 10 vite përvojë dhe është marrë mesatarja nga të tri propozimet. Gjithashtu, bordi, para shpalljes së konkursit, ka konsultuar dhe ka pasur dy takime me Inspektoratin e punës, të cilët kanë mbështetur konkursin me kriteret e parapara. Ajo tha se nuk konsideron se bordi ka bërë shkelje ligjore. Gjithashtu, ajo tha se nuk ka qenë e njoftuar se Bordi i RTK-së është i përfshirë në marrëveshjen e Ambasadës të Britanisë së Madhe, për të qenë ata monitorues të procesit.

Valon Ramadani, tha se bordi ka bërë shkelje ligjore me përcaktimin e kritereve të konkursit, dhe mbi këtë bazë, ka vend që të kërkohet inicimi i procedurës për shkarkimin e Bordit të RTK-së.

Nait Hasani, tha se është kompetencë e bordit të caktojë kriteret e konkursit, me qëllim të përzgjedhjes së kandidateve më të mirë.

Rasim Selmanaj, duke komentuar parafolësin, tha se qëndron fakti se bordi duhet të zgjedhë kandidatët më të mirë, por jo duke caktuar kritere kundërligjore dhe konkursi është në shpërputhje me ligjin në fuqi.

Xhevahire Izmaku, nuk u pajtua që në procesin e përzgjedhjes të marrin pjesë vëzhguesit e Ambasadës së Britanisë së Madhe, veçanërisht për drejtorin e RTK-së, duke theksuar se marrëveshja ka të bëjë për anëtarët e bordeve dhe agjencive, e jo për drejtor dhe se ftesa e bordit në takim është një proces i ngutshëm i komisionit.

Arban Abrashi, kërkoi nga bordi që të merren praktikat, shembujt nga agjencitë, kompanitë dhe bordet e tjera, të cilat i kanë si standard për përzgjedhjen e drejtorëve apo kryeshefave ekzekutivë.

3. Të ndryshme

Komisioni, në bazë të nenit 62 dhe shtojcës 2, pika 10 të Rregullores së Kuvendit, shqyrtoi njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me vazhdimin e funksionit të anëtarëve të Këshillit, deri në zgjedhjen e anëtarëve të rinj, me qëllim të ruajtjes së funksionimit të institucionit, për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme.

Komisioni, gjatë shqyrtimit, është bazuar në Përfundimin e Kryesisë të Kuvendit, të dt. 6 dhjetor 2011, nr. 04-P-065/k, në bazë të të cilit, në pikën 3 të përfundimit, ceket:

Me datën e skadimit të mandatit për kryetarët dhe anëtarët e organeve të pavarura, pushojnë të gjitha të drejtat dhe obligimet e tyre. Të gjitha veprimet e ndërmarra, pas datës së skadimit të mandatit, paraqesin shkelje ligjore.

Konstatim: Komisioni ka vlerësuar se nuk ekziston asnjë rrethanë e jashtëzakonshme dhe se anëtarët e KPMSHCK-së duhet të veprojnë sipas përfundimit të lartcekur.

Mbledhja përfundoi në orën: 14:20.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Nait Hasani